



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:067561

Datë: 15.06.2020

Numri i dokumentit: 00963091

P.nr.991/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit N.L nga, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 _ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 i (KPRK). duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë themelore në Prizren, PP.II.nr.2787-10/2018 , të datës 30.07.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Besim Susuri të pandehurit N.L, dhe mbrojtësit av.P.P me datë 15.06.2020 morri këtë:

A K T G J Y K I M

N.L i lindur më, i biri i L. L dhe nënës R., me banim në fsh. Komuna e Prizreni ka të kryer shkollën e mesme, i martuar babë i ... femive, shqiptar ,shtetas i R. të Kosoves.

ESHTE FAJTOR

1.Se me dt. 12.10.2018 rreht orës 22,30, në fsh. Komuna e Prizrenit, i pandehuri mbanë në pronësi, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin për armët pistoletën e tipit “...” 9mm, me mbishkrimin me nr.serik ngjyrë e zeze e cila sekuestrohet si dëshmi nga policia.

Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

2. Se në kohën dhe vendin e cekur si në përshkrimin faktik nën pikën I të aktakuzës i pandehuri me dijeni dhe në kundërshtim me ligjin për armët përdorë armen gjatë ahengut familjare përkatësisht pistoletën e tipit “...” ...mm, me mbishkrimin ... me nr .serik ... ngjyre e zeze shtinë dy hyre në ajër në shenje gëzimi se po e marton djalin e vëllaut e3 cila sekuestrohet nga policia.

Këso dore e ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 i KP.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 43, 44, 69,70 76, të KP të akuzuarit :

i shpall:

DËNIM ME GJOBE

Per veprne penale nen I te dispozitivit ne shume prej 300 (treqind) euro.

Per veprën penale si nen II te dispozitivit ne shumen prej 300 (treqind) euro.

Ne kuptim te nenit 80 te KP te akuzuari i shqipton

DENIMIN UNIK ME GJOBE

Ne shume prej 600 (gjashtëqind) euro. , te cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin, te njëjtit i zëvendësohet dënimi me gjobe me dënim me burg duke i llogaritur 1 (nje) dite burg me 20 euro, qe don te thote 30 dite burg.

Te akuzuarit i konfiskohet arma pistoleta e tipit “...” ...mm, me mbishkrimin me nr.serikngjyrë e zeze.

Obligohet I pandehuri qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarit i caktohet taksa ne lartësi prej 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë,.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2787-10/2018 , të datës 30.07.2019 ,ndaj te akuzuarit N.L nga fsh.... Komuna e Prizrenit për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 _ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par.1 i (KPRK).

I pandehuri N.L ne shqyrtim fillestar, në tërsi e pranon veprën për te cilën akuzohet, po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është bere vullnetarisht, dhe mbështetet ne faktet e qeshtjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit gjyqtari gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 _ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par.1 i (KPRK). Per veprën penale nen I te aktakuzës i shqiptoi ia shqiptoi dënimin me gjobe ne shume prej 300 euro, si dhe per veprën penale nen II te aktakuzës gjithashtu dënimin me gjobe ne shume prej 300 euro.

Ne zbatim te nenit 80 te KP-së te akuzuarit iu shqiptua dënimi unik ne shume prej 600 (gjashtëqind) euro, duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit. Ne përcaktimin e lartësisë se gjobës , gjykata pati per baze gjendjen e dobët sociale te te akuzuarit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese për të akuzuarin , pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej me vepra penale, sjelljen korrektë para gjykatës, si dhe moshën e tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Vendimi mbi konfiskimin u muar ne kuptim te nenit 62 par.2.7 te KP-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:067561, 15.06.2020

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.